REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
ZYRA E STREHIMIT

Nr. 305 Prot Maliq, më 22.1.2026

PROJEKT -VENDIM - NR. 9
PËR
PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E QIRASË SOCIALE PËR FAMILJET E STREHUARA NË BANESËN SOCIALE "ISH LABORATORI"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*", gërma f) ku thuhet se: "*vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi*", ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar, me ligjin nr. 48/2023nr.139/2015, neni 33 pika 20 ku thuhet se: "*Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira*", VKB nr.57 datë 25.08.2021 "*Për zhvendosjen e familjeve dhe strehimin e tyre në godinën e Ish Laboratorit Qëndror, ndarjen e apartamenteve dhe përcaktimin e qirasë mujore*" si dhe VKB nr.58 datë 25.08.2021 "*Për miratimin e rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e Banesave Sociale me qira pranë Ish Kombinatit të Sheqerit Maliq*", Këshillit të Bashkisë i

PROPOZOJMË

1. Të miratojë përjashtimin nga pagesa e qirasë për vitin 2026 e në vazhdim, deri në një vendim të dytë, për familjet e strehuara në Banesën Sociale "Ish Laboratori, si më poshtë. Familjet e strehuara në BSQ Ish Laboratori

Nr	Emër, atësia, mbiemër	Kategoria
1.	Edmond Haxhi Pero	Egjiptian
2.	Esat Riza Marjanaku	NE/Pension
3.	Piro Astrit Mete	Egjiptian
4.	Dorjan Hysen Terolli	Egjiptian
5.	Françesko Astrit Mete	Egjiptian/NE
6.	Shpëtim Selim Sulejmani	NE/Rom
7.	Erion Nazmi Rexha	Rom
8.	Natasha Adem Stoceni	Pak/Rom

2. Të falë detyrimet e prapambetura nga qiraja e papaguar gjatë viteve të kaluara për këto familje.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Zyra e Strehimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar .

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi	I.Shkëmbi		Dt. 21/01/2025
Miratoi Përgjegjës i Sektorit	L.Mullalli		Dt. 21/01/2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

ZYRA E STREHIMIT

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E QIRASË TË FAMILJEVE TË STREHUARA NË BANESËN SOCIALE "ISH LABORATORI"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*", gërma f) ku thuhet se: "*vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi*", ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar, me ligjin nr. 48/2023nr.139/2015, neni 33 pika 20 ku thuhet se: "*Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira*", VKB nr.57 datë 25.08.2021 "*Për zhvendosjen e familjeve dhe strehimin e tyre në godinën e Ish Laboratorit Qëndror, ndarjen e apartamenteve dhe përcaktimin e qirasë mujore*" si dhe VKB nr.58 datë 25.08.2021 "*Për miratimin e rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e Banesave Sociale me qira pranë Ish Kombinatit të Sheqerit Maliq*".

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, veçanërisht neni 54, shkronja "f", që i njeh Këshillit Bashkiak kompetencën për vendimmarrje mbi taksat, tarifat dhe detyrimet vendore, si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, Këshilli Bashkiak ka të drejtën dhe detyrimin ligjor të përcaktojë masën e qirasë sociale në përputhje me gjendjen ekonomike dhe sociale të familjeve përfituese.

Sipas nenit 33 të ligjit nr. 22/2018, masa e subvencionit të qirasë është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes dhe subvencioni mund të mbulojë deri në 100% të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike ose që janë në kushtet e përfitimit të saj, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira.

Nga verifikimet administrative dhe sociale të kryera nga Zyra e Strehimit rezulton se familjet e strehuara në Banesën Sociale të përshtatur në godinën e Ish Laboratorit, pranë Kombinatit të Sheqerit Maliq, ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe sociale, me të ardhura të ulëta, shumë të ulëta ose pa asnjë të ardhur si dhe pa alternativa të tjera strehimi në pronësi apo përdorim.

Këto familje i përkasin shtresave vulnerabël, kryesisht minoriteteve Rom dhe Egjiptian, dhe përballen me problematika të theksuara sociale dhe shëndetësore. Vendosja e një detyrimi financiar për pagesën e qirasë, edhe në nivel minimal, është disproporcionale me gjendjen e tyre ekonomike.

Në këtë kontekst, përjashtimi nga pagesa e qirasë sociale për këto familje përbën zbatim të drejtpërdrejtë të dispozitave të ligjit nr. 22/2018 dhe të kompetencave të Këshillit Bashkiak, si dhe një masë sociale të arsyetuar, që synon garantimin e strehimit, stabilitetin social dhe mbrojtjen e familjeve në nevojë.

Për më tepër, të ardhurat nga qiraja e banesave sociale, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk përbëjnë të ardhura për buxhetin e bashkisë, por përdoren për administrimin dhe mirëmbajtjen e fondit të banesave sociale. Në kushtet kur familjet kontribuojnë në mirëmbajtjen dhe pastrimin e ambjenteve të banesës sociale, përjashtimi nga pagesa e qirasë nuk cenon interesat financiare të bashkisë.

Duke marrë në konsiderate arsyet që u thane më lart dhe vlerësuar angazhimin e tyre për mirëmbajten e zakonshme dhe pastrimin e objektit, propozojmë përjashtimin nga pagesa e sociale për vitet 2026 e në vazhdim me qëllim vazhdimin e mbështetjes së tyre dhe duke i nxitur në dhënien e kontributit në mirëmbajtjen dhe pastrimin e ambjenteve të banesës Sociale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi	I.Shkëmbi		Dt. 21/01/2025
Miratoi Përgjegjës i Sektorit	L.Mullalli		Dt. 21/01/2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ